



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.64/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi, kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Kosovski Savez, me seli në Leposaviq, e parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa e subjektit politik Kosovski Savez, me seli në Leposaviq, e parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkeljes se dispozitave të Kodit të Miresjelljes për periudhën e fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës të datës 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 30.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë të parashtruar nga subjekti politik Kosovski Savez, ku pretendohet më datë Data 28.12.2025, aktivistët e subjektit politik Kosovski Savez vunë re se aktivistët e Listës Serbe në komunën e Leposaviqit kishin ngjitur materialin e tyre promovues në objekte publike dhe sipërfaqe publike, duke shkelur kështu rregulloren zgjedhore 7/2024. Sipas parashtruesit të ankesës materialet janë vendosur në Rr. 24 Nëntori – figura 1 dhe 2, Rr. Ibarski Odred – figura 3, 4 dhe 5, Rr. Vojvoda Mishiq – figura 6, 7 dhe 8, Rr. Kryengritësit e Toplicës – figura 9, 10 dhe 11, Rr. 24 Nëntori – lokal në pronësi të Komunës së Leposaviqit – figura 12 dhe 13, Rr. 24 Nëntori – kiosk në pronësi të Komunës së Leposaviqit, pranë Postës së Kosovës – figura 14 dhe 15, Rr. Ushtria e Jugosllavisë – Sheshi – figura 16 dhe 17, Ndërtesa e Gjykatës Komunale në Leposaviq – figura 18 dhe 19, Rr. Ushtria e Jugosllavisë – kiosk në pronësi të Komunës së Leposaviqit – figura 20 dhe 21, Rr. Vëllezërit Radovanoviq – Soçanicë – figura 22 dhe 23, Stacion Autobusi – fshati Kamenicë, drejtim Mitrovicë – figura 24 dhe 25, Stacion Autobusi – fshati Kamenicë, drejtim Leposaviq – figura 26 dhe 27, Stacion Autobusi – fshati Slatinë, drejtim Mitrovicë – figura 28 dhe 29, Stacion Autobusi – fshati Slatinë, drejtim Leposaviq – figura 30 dhe 31, Stacion Autobusi – fshati Slatinë, drejtim Mitrovicë – figura 32 dhe 33, Stacion Autobusi – fshati Slatinë, drejtim Leposaviq – figura 34 dhe 35, Stacion Autobusi në Soçanicë, drejtim Leposaviq – figura 36 dhe 37, Soçanicë, rrugë për fshatrat Krushevicë, Jevicë, Moshenicë, Borçanë – figura 38, 39 dhe 40, Lokal në pronësi të Komunës së Leposaviqit, 30 metra nga Shkolla "Vuk Karadžić" në Soçanicë, ku ndodhen qendrat e votimit – figura 41 dhe 42, Stacion Autobusi në fshatin Dobravë, drejtim Leposaviq – figura 43 dhe 44, Stacion Autobusi në fshatin Dobravë, drejtim

Mitrovicë – figura 45 dhe 46, Rr. Ndriçimi në fshatin Dobravë – figura 47, 48 dhe 49, Rr. Nemanjina – Leposaviq – figura 50 dhe 51, Hyrja në Stacionin e Autobusëve të Leposaviqit – figura 52 dhe 53, Stacioni i Autobusëve i Leposaviqit – figura 54 dhe 55, Rr. Nemanjina, Leposaviq – figura 56 dhe 57, Rr. Nemanjina – lokalë në pronësi të Komunës së Leposaviqit – figura 58 dhe 59, Rr. Dositej Obradoviq, Leposaviq. Shtëpia e Kulturës Leposaviq – figura 60 dhe 61, Rr. Kërçunë, Leposaviq, Ndërtesa e Fakultetit të Trafikut dhe i Policisë Kufitare të Kosovës – figura 62 dhe 63, Rr. Kërçunë, Leposaviq – figura 64 dhe 65, Rr. 7 Korriku, Leposaviq – figura 66, 67, 68 dhe 69, Rr. Milan Milanoviq, Leposaviq – figura 70 dhe 71, Rr. Heronjve të Kosovës, Leposaviq – figura 72 dhe 73, Stacion Autobusi – fshati Kajkovë, drejtim Mitrovicë – figura 74 dhe 75, Stacion Autobusi – fshati Kajkovë, drejtim Jarinjë – figura 76 dhe 77, Stacion Autobusi – Kajkovë e Poshtme, drejtim Mitrovicë – figura 78 dhe 79, Stacion Autobusi – fshati Dren, drejtim Mitrovicë – figura 80 dhe 81, Stacion Autobusi – fshati Dren, drejtim Jarinjë – figura 82 dhe 83, Hyrja në Leshak, mbikalimi – figura 84 dhe 85, Rr. Ivo Lola Ribar, Leshak – figura 86, 87 dhe 88, Rr. Kopaonik, Leshak – figura 89 dhe 90, Rr. Karađordeva, Leshak – figura 91 dhe 92, Rr. Gojko Baćanin, Leshak – figura 93 dhe 94, Rugë për fshatin Ostraç, Leshak – figura 95 dhe 96, Rr. Vëllezërit Matoviq, Leshak, nëntrafostacion – figura 97 dhe 98, Rugë për fshatrat Gulijë dhe Drenovë – Leshak – figura 99 dhe 100, Fshati Borovë, Leshak – figura 101, 102 dhe 103, Separimi – Leshak – figura 104 dhe 105, Stacion Autobusi, fshati Kamen, drejtim Mitrovicë – figura 106 dhe 107, Stacion Autobusi, fshati Kamen, drejtim Jarinjë – figura 108 dhe 109, Stacion Autobusi, fshati Jarinjë, drejtim Mitrovicë – figura 110 dhe 111, Stacion Autobusi Jarinjë, drejtim Kufiri me Serbinë – figura 112 dhe 113, Rr. Vëllezërit Matoviq, Leshak – figura 114 dhe 115, Rr. Vëllezërit Matoviq, Leshak – ndërtesa e Shtëpisë së Kulturës Leshak – figura 116 dhe 117, Stacion Autobusi – Flotacioni, Leposaviq, drejtim Mitrovicë – figura 118 dhe 119, Sheshi në Soçanicë – figura 120, 121, 122 dhe 123. Propozojnë që PZAP-ja ta miratojë ankesën si të bazuar, dhe që në përputhje me rregulloret të shpallë dënimet përkatëse kundër subjektit politik Lista Serbe. Fatkeqësisht deri më tani të gjitha dënimet e shpallura nga PZAP-ja nuk kanë dhënë rezultat në kuptimin që Lista Serbe të heqë materialin propagandistik nga sipërfaqet publike, por përkundrazi - ata e kanë rinovuar materialin propagandistik. Për të gjitha fotografitë e bashkëngjitura që ndodhen në aparatet tanë, posedojmë edhe kohën e saktë të fotografimit. Si dëshmi kanë bashkëngjitur fotografitë disa fotografi.

Subjekti politik Lista Serbe, ka paraqitur përgjigje në ankesë, në të cilën theksojnë se ankuesi ka lënë pas dore afatin e parashikuar me rregulla prej 24 orësh për të paraqitur ankesën, sepse, siç e përmend edhe vetë në ankesën e tij, shkeljen e supozuar të Rregullores nr. 7/2024 e ka vënë re më 28.12.2025. vitit, ndërsa ankesën e tij e ka paraqitur Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa 48 orë më vonë. Kërkojnë që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa duhet ta hedhë poshtë këtë ankesë si të paraqitur jashtë afatit. Propozojnë që PZAP ta miratojë përgjigjen ndaj ankesës si të bazuar, që PZAP ta hedhë poshtë ankesën.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

-Ankesa është e palejuar.

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr.15/2024 Zgjedhjet e Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme neni 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.18 përcakton: *se një ditë pas shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme dhe/apo të jashtë zakonshme, KQZ nxjerr vendim për caktimin e afateve kohore dhe planin e aktiviteteve për zgjedhje për:..... 2.18 fushatën zgjedhore si dhe afatet për tubimin e fushatës zgjedhore.*

Presidentja e Republikës së Kosovës me dekretin me nr. protokoli 210/2025 i datës 20.11.2025 ka shpallur Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe si datë të votimit ka caktuar datën 28 Dhjetor 2025.

Sipas nenit 34 dhe 44 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore të subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe të drejtat e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore sipas kushteve të saktësuara në Kodin e Sjelljes. Neni 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i këtij ligji përcakton se gjatë periudhës së fushatës zgjedhore të subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tij ndalohej *“vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterave, ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave , në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut...”*.

Pretendimi ankimor i parashtruesit të ankuesit se aktivistët e Listës Serbe me datë 28.12.2025 kishin ngjitur materialin e tyre promovues dhe kështu kishin shkelur rregulloren zgjedhore 7/2024, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që Rregullorja zgjedhore nr.7/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, është Rregullore që përcakton rregullat e fushatës së zgjedhjeve.

Andaj duke u bazuar në dekretin Presidencial, si dhe në dispozitat e lartcekura ligjore me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar gjatë ditës së zgjedhjeve, Paneli konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar ngase shkeljet e pretenduara janë paraqitur për ditën e votimit ndërsa dispozitat e sipërcituara bëjnë fjalë dhe vlejné e ndalojnë veprimet e tilla si në ankesë vetëm për fushatë zgjedhore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të 115 par.1 dhe nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZP.Anr.64/2025 më datën 31.12.2025



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.